

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e nëntë të rregullt, e mbajtur më datën 27.12.2024, merr këtë:

**V E N D I M Nr.54/2024/KG**

**PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT NGA MBLEDHJA E KUVENDIT, E  
MBAJTUR MË DATËN 15.11.2024**

**Neni 1**

Miratohet procesverbali nga mbledhja e pestë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 15.11.2024.

**Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e pestë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 15.11.2024.


**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



**Kryesuesi i Kuvendit**

**Milan Dimitrijević**



## PROCESVERBALI

Nga mbledhja e pestë e jashtëzakoshme e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 15.11.2024 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën 12:00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje nga 19 asamblistë janë të pranishëm 16 asamblistë dhe ka kuorum, ndërsa mungojnë Millosh Dimiq, Nebojsa Markoviq dhe Granit Gashi.

Në mbledhje morën pjesë edhe: përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesit e KFOR-it, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, drejtoresha e Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Mjedisit, drejtori i NPK-së “Ekologjia” Sh.A. Graçanica, kryetari i Kuvendit të aksionarëve të NPK-së “Ekologjia” Sh.A. Graçanica, mediat, shefi i Shërbimit të Tatimit, Shërbimi për Përkthime dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme është mbajtur mbledhja e pestë e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzëri ka dhënë mendim pozitiv për rendin e ditës të caktuar për mbledhjen e sotme të Kuvendit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit tha se në bazë të nenit 44 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040) është caktuar rendi i mëposhtëm i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e rregullt, e mbajtur më datën 31.10.2024.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e normave tatimore për pronën e paluajtshme për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së NPK “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë për ndarjen e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër, me propozim të drejtorit ekzekutiv të NPK “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Dejan Dimitrijeviq.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për ndryshimin dhe plotësimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve në mes të Komunës së Graçanicës dhe NPK “Ekologjia” Sh.a. Graçanicë, me

propozim të kryetarit të Kuvendit të aksionarëve të NPK "Ekologjia" Sh.a. Graçanicë, Sasha Daniq.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për ndryshimin e emrit të rrugëve, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq.

7. Pyetjet dhe përgjigjet nga mbledhja e tretë e jashtëzakonshme e KK të Graçanicës, e mbajtur më datën 24.09.2024.

8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e rregullt, e mbajtur më datën 31.10.2024.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 16 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e parë të rendit të ditës.**

**Në mbledhje është i pranishëm asamblisti Nebojsha Markoviq, gjithsej 17 asamblistë janë të pranishëm dhe ka kuorum.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për rritjen e buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, e paraqiti propozimin për rritjen e buxhetit në një shumë prej 198,179.64€ për vitin 2024 nga të hyrat vetanake të komunës, ku shuma prej 98.179,64 € do të transferohet në subvencione dhe transfere në kodin e programit Zyra e kryetarit, ndërsa shuma prej 100,000.00€ në investime kapitale për projektin "Ndërtimi i ndërtesave për banim social" (projekt i vjetër).

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e normave tatimore për pronën e paluajtshme për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, shpjegoi se në përputhje me nenin 9 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Kuvendi duhet të marrë vendim për normat tatimore, ndërsa normat tatimore variojnë nga 0.10% deri në 1.00%. U propozuan normat tatimore nga 0,10% në 0,18%. Krahasuar me normat për vitin 2024, normat për njësitë komerciale të objekteve u ulën nga 0,28% në 0,18%, për njësitë industriale të parcelave nga 0,18% në 0,16% dhe për njësitë industriale të objekteve me 0,24 deri në 0,16%.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 16 asamblistëve “Pro”, dhe një votë “Abstenim” të Vlladica Qurçiqit, e miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së NPK “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë për ndarjen e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër, me propozimit të drejtorit ekzekutiv të NPK “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Dejan Dimitrijeviq.

Drejtori ekzekutiv i NPK-së “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Dejan Dimitrijeviq, tha se njëësia e punës e NPK-së “Ekologjia” ka rreth 90 punëtorë, ndërsa që nga dita e themelimit zyrtarisht kanë vetëm një hapësirë me një sipërfaqe rreth 18 m<sup>2</sup>. Gjatë këtij viti ishte dashur të fillonte ndërtimi i objektit të administratës, magazinës dhe parkingut për Ekologjinë, por dështoi për shkak të disa arkëtimeve të detyrueshme që uli buxhetin e komunës. Që nga themelimi, ne kemi ndërruar disa lokacione, nga një kontejner prej 15 m<sup>2</sup>, pastaj kemi qenë në një akomodim privat, nga i cili është dashur të largohemi sepse pronari e ka shitur atë parcelë. E kam lexuar procesverbalin nga mbledhja e mbajtur në mars, kur i njëjti propozim nuk është miratuar, si dhe arsyetimin e disa asamblistëve që nuk ishin pro miratimit. Ai ka shpjeguar se me vendim të Kuvendit nga mandati i kaluar apo kontratë të lidhur me Kabinetin, nga pagesa e qirasë për lokalet janë përjashtuar KQZ-ja, avokati Negovan Sharanoviq, OJQ “Avenija”, Organizata për Persona të Kidnapuar dhe të Zhdukur, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zyra për Komunitete dhe Kthim. Në Rregulloren nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, përkatësisht nenin 5 “*Kriteret për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale*” paragrafin 6 thuhet: “*Hapësirat publike dhe pajisjet teknike për funksionimin normal dhe ofrimin e mjaftueshëm të shërbimeve publike ndaj qytetareve duhet të jenë të siguruara nga themeluesi.*” dhe siç e dini, themelues dhe pronar 100% i ndërmarrjes NPK “Ekologjia” është Komuna e Graçanicës.

Kryesuesi u përgjigj se kërkesa e Ekologjisë duhej t’i dërgohej kabinetit të kryetares dhe kur në një nga mbledhjet e mëparshme të Kuvendit, Ekologjisë i ishte shlyer borxhi për shfrytëzimin e lokalit, atëherë u tha se ishte e afatshkurtër dhe se për Ekologjimë po ndërtohet një objekt të ri. Askush nuk ka asgjë kundër jush (drejtori i Ekologjisë Dejan Dimitrijeviq), por kushdo që mban një post publik është subjekt i kritikave.

Drejtori ekzekutiv i NPK-së “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Dejan Dimitrijeviq, është përgjigjur se nëse Kuvendi nuk është kompetente për këtë kërkesë, atëherë është dashur të marrë përgjigje se kush është kompetent, kabineti apo dikush tjetër. Në procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit të mbajtur më 29 mars, asamblistja Odallovij tha se: “Ekologjia është në gjendje të marrë me qira një ekskavator për 12,000 euro dhe të krijojë vetëm 800 euro të ardhura prej tij, prandaj nuk shoh arsye që të mos i paguajë qiranë komunës”. Ky informacion nuk është i vërtetë dhe kjo nuk ka ndodhur.

Kryesuesi e ndërpreu prezantimin e drejtorit Dimitrijeviq, duke i thënë që t’i kthehej kërkesës, ndërsa për gjithçka tjetër ai mund të flas nën pikën “Të ndryshme”. Nëse ky informacion është në raport, ai është i disponueshëm publikisht dhe i nënshtrohet kontrollit.

Drejtori ekzekutiv i NPK-së “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Dejan Dimitrijeviq, është përgjigjur se e pranon gabimin e vetëm, sepse në kërkesën e paraqitur në mars nuk i është referuar nenit 5 paragrafit 6 të Rregullores nr.02/2013. Gjithashtu, shumica e vendimeve të mara nga Kuvendi lidhur me NPK-në “Ekologjia”, nuk është dashur të diskutohen nga Kuvendi, por ne e kemi bërë këtë për hir të transparencës.

Kryesuesi konfirmoi se vendimet e Kuvendit lidhur me PUK-në “Ekologjia” nuk i nënshtrohen vlerësimit të ligjshmërisë, duke thënë se nëse drejtori i Ekologjisë dëshiron të jetë transparent, atëherë duhet të paraqesë një raport, të cilin duhet ta mbrojë kryetari i Kuvendi i aksionarëve të NPK-së “Ekologjia” Sh/A. Graçanic, Sasha Daniq.

Asamblistja Sonja Odallovic, para partisë “SRPSKA”, i është përgjigjur drejtorit Dimitrijeviq, sepse ajo që ka thënë atëherë është vërtetuar me raportin që na e ke dërguar atëherë, është shkruar se marrja me qira e një ekskavatori kushton 12.000 euro dhe se ju ke pasur fitim 800 euro. Në terren ju silleni sikur të ishte kompania juaj private, disa gjëra nuk i bëni në mënyrë transparente dhe disa aktivitete nuk i kryeni ashtu siç paguheni. Ju thatë se keni shumë aktivitete si dhe që e keni zgjeruar biznesin. Nuk e kuptoj prandaj pse nuk jeni në gjendje të paguani qiranë nga e cila kërkonte të liroheni nga pagesa.

Drejtori ekzekutiv i NPK-së “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Dejan Dimitrijeviq, u përgjigj se në fillim kishin 2 kamionë dhe tani kanë 6-7 kamionë dhe pajisjet i marrin me qira në kushtet më të mira të mundshme në treg dhe mund të ndodhë që të ardhurat të jenë zero sepse, si për shembull, kur kemi punuar për kishën, për komunën, për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ku nuk i kemi paguar shërbimet.

Asamblistja Sonja Odallovic, para partisë “SRPSKA”, tha se drejtori Dimitrijeviq në raport tregon vetëm atë që i përshtatet, e nuk është kështu në terren, si për shembull deponia mbi varrezat e reja.

Drejtori ekzekutiv i NPK-së “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Dejan Dimitrijeviq, u përgjigj se deponia është nën juridiksionin e Drejtorisë së Inspektionit dhe vetëm një pjesë e vogël pastrohet dhe rregullohet nga Ekologjia.

Asamblistja Sbezhana Jovanovic, para partisë “SRPSKA”, tha se vite më parë ka kërkuar rritje të pagave të punëtorëve të Ekologjisë që pastrojnë rrugët dhe atyre u është rritur paga vetëm një herë dhe premtimi që e kemi marrë që punëtorëve do të rritet paga nuk është bërë ashtu siç duhet. Ajo e shprehu kundërshtimin e saj ndaj këtij propozimi, duke theksuar se ligji parashikon ndarje të hapësirës, por jo edhe përjashtimin nga pagesa e qirasë. “Askund nuk thuhet se hapësira duhet të përdoret pa paguar”. Çmimi i qirasë nuk është i lartë dhe besoj se është një mënyrë për të mësuar që duhet ta respektoni këtë komunë dhe Kuvendin dhe të merrni përgjegjësi financiare. Sa i përket pyetjes që të tjerit janë të përjashtuar nga pagesa, mendoj se kjo pyetje është për kabinetin e komunës”.

Drejtori ekzekutiv i NPK-së “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Dejan Dimitrijeviq, u përgjigj se pagat e punëtorëve janë korrigjuar dhjetorin e kaluar dhe në korrik të këtij viti dhe pesë herë që nga fillimi i punës së Ekologjisë. Ata duhet të sigurojnë 60 mijë euro në muaj për pagat e punëtorëve.

Asambleti Millosh Todoroviq, para partisë “SRPSKA”, tha: “Vetëm një gjë nuk është e qartë për mua - ne duam t'i japim zyrat tona kompanisë sonë që e kemi themeluar dhe ata të na paguajnë për të. Unë do ta thërrisja Shërbimin ligjor për të na sqaruar - a është e mundur kjo, a qëndron kjo? Themi që nuk mund të jepet asnjë metër katror pa vendim të kuvendit. Kjo ishte për të gjitha parcelat për të cilat kemi diskutuar, kjo është parcela jonë, kompania jonë, ndërmarrja jonë dhe unë jam me të vërtetë pro vënies në përdorim të saj, sepse gjithsesi ishte bosh. Unë nuk jam kundër për t'ia dhënë kompanisë sonë në përdorim”.

Asambleti Dejan Jevtiq, para partisë “SRPSKA”, tha: “Më intereson pse ne si Kuvend nuk mund t'i lëshojmë ato lokale kur e kemi bërë shumë herë më parë. Gjithmonë kam qenë pro që të mos i japim vetëm hapësirat që janë për ndërmarrjen tonë, por edhe lokalet personave privatë – parukierja, Radio 038, të gjithëve i kemi dalë në ndihmë në ndonjë mënyrë. Unë jam për të ndihmuar të gjithë, jo vetëm kompanitë tona që ne jemi themelues, por edhe të gjithë të tjerët - pse jemi ne këtu? Nëse nuk i ndihmojmë njerëzit tanë, si dhe ndërmarrjen tonë, themelues i së cilës është Kuvendi. Tani në vend që ta marrim atë vendim, ne si Kuvend po ikim nga kjo, nuk e kuptoj pse po ikim nga ky vendim? Pse? Nuk e kuptoj pse po ikim nga ajo përgjegjësi?”.

Asambletja Jellena Dimitrijeviq, para partisë “SRPSKA”, tha se nëse tashmë kërkojnë përmirësimin e kushteve për punëtorët, rritjen e pagave, atëherë edhe ne duhet ta miratojmë këtë kërkesë.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi me votat e 4 asambletë “Pro” - Millosh Todoroviq, Jellena Dimitrijeviq, Ljubisha Karaxhiq dhe Dejan Jevtiq, 5 vota “Kundër” - Sonja Odallovicq, Bojan Zhiviq, Zoran Danilloviq, Snezhana Jovanoviq dhe Marija Grbiq dhe 8 vota “Abstenim”, nuk e miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për ndryshimin dhe plotësimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve në mes të Komunës së Graçanicës dhe NPK “Ekologjia” Sh.a. Graçanicë, me propozim të kryetarit të Kuvendit të aksionarëve të NPK “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Sasha Daniq.

Kryetari i Kuvendit të aksionarëve të NPK “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Sasha Daniq, tha se kjo kërkesë vjen për faktin se Komuna e Graçanicës ka qenë e obliguar që në bazë të raportit të auditimit të jashtëm t'i ndërpresë kontratat me kompanitë që i kanë ofruar këto shërbime dhe shpjegoi se ndryshimet dhe plotësimet e kontratës trevjeçare, të cilën NPK “Ekologjia” e ka të arritur me Komunën e Graçanicës, i referohen zgjerimit të aktiviteteve të kësaj ndërmarrjeje përmes Aneksit 3, ku neni 14 pika 1 plotësohet me “l) punimet gjatë verës dhe dimrit; m) punët e pastrimit gjatë dimrit; n) punimet bravarise dhe o) punët përgatitore; të cilat janë në përputhje me statutin që mund të ofrojë kompania”. Ai shtoi se është duke u ndryshuar edhe një aneks tjetër i kontratës bazë, që i referohet çmimeve të ofrimit të shërbimeve.

“I keni tabelat lidhur me përshkrimin e punëve dhe çmimet. Duke pasur parasysh se lista është e gjatë, nuk do ta lexoj, por dua të theksoj këtu se çmimet janë shumë më të ulëta se çmimet e

shërbimeve që ofrojnë kompanitë me të cilat kemi punuar deri më tani”. Ai përmendi se kjo kontratë po bëhet për shkak të urgjencës, sepse po vjen periudha e dimrit dhe do të duhet pastrimi i rrugëve nga reshjet.

Asambleti Millosh Todoroviq, para partisë “SRPSKA”, e pyeti Daniqin nëse është pjesë e punës së tij si kryetar i Kuvendit të aksionarëve të NPK-së “Ekologjia” që të sigurojë lokale për punëtorët e NPK-së “Ekologjia”.

Kryetari i Kuvendit të aksionarëve të NPK “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, Sasha Daniq, u përgjigj se nuk është pjesë e punës së tij, e më pas i ka lexuar kompetencat e Komisionit komunal të aksionarëve dhe kompetencat e Bordit të drejtorëve nga Statuti i Ekologjisë. Nga Statuti, ai e lexoi nenin 23 paragrafin 1, ku thuhet: “Bordi i drejtorëve është i obliguar të mbajë së paku një mbledhje të rregullt vjetore”; si dhe paragrafin 2, ku thuhet: “Përveç mbledhjes së rregullt vjetore, mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen edhe me kërkesë të: 1. Kryetarit të Bordit të drejtorëve; 2. Shumicës së anëtarëve të Bordit të drejtorëve; 3. Komisionit komunal të aksionarëve; 4. Kryetarit të komunës; 5. Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi tha se kompetenca e Bordit të drejtorëve është: “Kryen detyra të tjera të nevojshme për afarizmin e shoqërisë, në përputhje me legjislacionin aktual”, që do të thotë se ata kanë mundësi t'i zgjerojnë kompetencat e tyre dhe të mos takohen vetëm një herë në vit, sepse Ekologjia vazhdimisht ka probleme, ndërsa ju duhet ta ndihmoni punën e Ekologjisë dhe të jeni një lidhje ndërmjet Komunës së Graçanicës dhe Ekologjisë.

Asambletja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, tha: “Këtë kërkesë e kemi diskutuar në një mbledhje të veçantë të grupit tonë të partisë dhe sigurisht jemi dakord për këtë, shumica prej nesh që kemi qenë të pranishëm”.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 16 asambletëve “Pro”, dhe një votë “Abstënim” të Vlladica Qurçiqit, e miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për ndryshimin e emrit të rrugëve, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, tha se në bazë të kërkesave të qytetarëve kanë pasur tri propozime për ndryshimin e emrit të rrugës dhe atë: “Beogradska” në “Milana Ivića” në Graçanicë (kërkesa e datës 5 gusht 2022); “Kajmakčalanska” në “Stojana Maksimovića Taka” në Graçanicë (kërkesë nga maji 2024), dhe “Pensilvania” në “Ohio” në Marigona Residence (kërkesë nga korriku 2024).

Asambletja Sonja Odalloviq, para partisë “SRPSKA”, tha se nuk ka asgjë kundër kërkesës së qytetarëve për ndryshimin e emrit të rrugës, sepse ata kanë të drejtë ta bëjnë këtë dhe është e ligjshme. Në komunitetin tonë ka shumë qytetarë të merituar që duhet të marrin emrat e

rrugëve, e njëri prej tyre është kryetari i parë i Komunës së Graçanicës. Do të përmend edhe babain tim, Sllobodan Iliqin, i cili luftoi për mbijetesë dhe mbijetesë që nga viti 2000.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiç, u përgjigj se ishte e pranishme në njërin nga mbledhjet e para të këtij Kuvendi, kur asamblisti Todorović propozoi që një rrugë në Dobrotin të emërohej me emrin e kryetarit të parë, Bojan Stojanović dhe ku asamblisti Qurçiq e mbështeti atë propozim, por që atëherë nuk e kemi pranuar asnjë kërkesë me nënshkrimet e qytetarëve.

Asamblisti Bojan Zhiviç, para partisë “SRPSKA”, tha se nuk ka asgjë kundër kërkesave të qytetarëve për ndryshimin e emrit të rrugëve, por nëse Kuvendi i miraton këto kërkesa, mund të përfundojmë në një situatë që të kemi shumë kërkesa nga qytetarët të cilët do të konsiderojnë se rrugët duhet të emërtohen me emrin e një nga të vdekurit e tyre, përkatësisht mund ta humbim një rrugë si për shembull emrin e rrugës “Mbreti L Lazar”, “Mbreti Milutin”. Ai do të votojë kundër këtij propozimi.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë “SRPSKA”, tha se nuk është pro propozimit për ndryshimin e emrit të rrugës në Kishnicë dhe ndryshimi i saj nuk bëhet në këtë mënyrë.

Asamblisti Millosh Todorović, para partisë “SRPSKA”, tha se këto propozime duhet t’i shqyrtojnë pak më mirë dhe me studim, si dhe të përfshihen qytetarët dhe këshillat lokale.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiç, para partisë “SRPSKA”, tha se në këtë çështje duhet të përfshihen Këshillat lokale, sepse në vitin 2015/16 kam qenë edhe anëtar i Këshillit lokal të Llapllasellës për ndryshimin e emrave të rrugëve, për të cilin është dashur pëlqimi i banorëve dhe miratimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe menaxhmentit të Komunës së Graçanicës.

Asamblisti Dejan Jevtiç, para partisë “SRPSKA”, tha se banorët që jetojnë në një rrugë kanë të drejtë të kërkojnë ndryshimin e emrit të asaj rruge nëse paraqesin kërkesë me nënshkrime, siç kanë paraqitur tani një kërkesë me nënshkrime. Njoh shumë njerëz që nuk u pëlqen emri i rrugës dhe heshtin, sepse dikush më pas mori një vendim pa pëlqimin e tyre.

Kryesuesi tha se ka marrë informacion nga disa anëtarë të Këshillave lokale se me ndryshimin e emrave të rrugëve qytetarët do të kenë probleme administrative. Ai sugjeroi që kjo pikë të kalohet në mbledhjen e radhës, në mënyrë që ndërkohë të kontaktohen Këshillat lokale dhe të konsultohen qytetarët.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi njëzëri me votat e 17 asamblistëve “Pro” propozimin e kryesuesit që kërkesat për ndryshimin e emrave të rrugëve të shqyrtohen fillimisht nga Këshillat lokale.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Pyetjet dhe përgjigjet nga mbledhja e tretë e jashtëzakonshme e KK të Graçanicës, e mbajtur më datën 24.09.2024.

Asambleti Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, pyeti se kur do të fillojë shpronësimi i tokës në lidhje me kishën në Llapllasellë?

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se me hyrjen në fuqi të vendimit të Kuvendit për shpronësimin e tokës për qëllim të varrezave ortodokse, pronarët e parcelave janë njoftuar, është vendosur ndalim në kadastër deri në kryerjen e gjithë procesit, ndërsa kërkesa për vlerësimin e tokës i është dërguar ministrisë.

Asambleti Millosh Todoroviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti se kur do të bëhet zgjerimi i rrugës “Dositejeva” në Graçanicë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se është bërë shpronësimi i tokës për atë projekt. Është dashur një pjesë e rrugës të zgjerohet, por nuk kemi mundur sepse këtë muaj janë ndërprerë të gjitha kontratat afatgjata me kompaninë që kishim për asfaltimin, prandaj tenderi është në procedurë.

Asambleti Millosh Todoroviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti a e ka pranuar Drejtoria e Urbanizmit kërkesën për shpronësim sepse një pjesë e rrugës afër restorantit “Asra” ndodhet në tokë private.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se nuk është i njoftuar me këtë kërkesë dhe se duhet të kontrollohet kjo.

Asambleti Vlladica Qurçiq, para partisë “SRPSKA”, e pyeti drejtoreshën e urbanizmit: “Pse deri më tani nuk është bërë asgjë për sigurinë e nxënësve në stacionin e autobusit afër Qendrës së shkollave të mesme, sepse para 3 vitesh u tha se një ishull dhe një rampë do të instalohen një rampë atje?”

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se asambleti Qurçiq ka të drejtë, por fatkeqësisht nuk është zgjidhur deri më tani sepse gjithmonë mungojnë rampat apo bordurat në kontratat afatgjata. Shpresojmë që me kontratën tonë të re të vendosim diçka sepse me sa duket nuk respektohen tabelat që janë të vendosura që të vlejnjë vetëm për parkimin e autobusëve në një periudhë të caktuar.

Asambleti Vlladica Qurçiq, para partisë “SRPSKA”, e paraqiti problemin me gropat e mëdha në Dobrotin, po ashtu ka një gropë në kthesën e Sushicës dhe në Gushtericën e Poshtme dhe Livagjë. Ai pyet se kush e ka dhënë lejen dhe si janë vendosur policët e shtrirë pranë marketit të ri pranë lokalit “Bela Vista”.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se në bazë të kërkesës drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike ka miratuar vendosjen e policëve të shtrirë në Llapllasellë pranë restorantit “Bela Vista” dhe afër marketit të ri (për faktin se kanë hapur asfalt për t'u lidhur me rrjetin elektrik). Gropat dhe riparimet paguhen nga mallrat dhe shërbimet dhe aktualisht nuk kemi një kompani që do ta bënte këtë. Rruga për në Dobrotin është rrugë magjistrale, ndërsa nga Ministria e Infrastrukturës është dashur ta merrnim pëlqimin për ndërtimin e rrugës, por tani ministria tha se ajo do ta bëjë këtë.

Asambletja Snezhana Jovanović, para partisë "SRPSKA", tha se rampa tek Qendra e shkollave të mesme duhet të vendoset sa më shpejt për sigurinë e fëmijëve dhe për këtë është diskutuar edhe në Këshillin për Siguri.

Asambleti Ljubisha Karaxhiq, para partisë "SRPSKA", tha se problemi është në projektin e ish-drejtoreshës së urbanizmit, të cilin e kemi kritikuar. Është e nevojshme që Drejtoria e Urbanizmit ta bëjë një projekt të ri në mënyrë që nxënësit të jenë të sigurt dhe projekti të jetë i mirë. Në atë pjesë, pa dijeninë e Këshillit lokal, është rregulluar rrjedha e lumit Graçanka në mënyrë shumë të keqe dhe të mjerë. Është e nevojshme që të rregullohet edhe parkingu rreth sallës së tenisit dhe urës për këmbësorë.

Kryesuesi tha se këtë çështje do ta diskutojë me kryetaren e Komunës së Graçanicës dhe se do të kërkojë që me procedurë urgjente të sigurohen mjete për projektin nga të hyrat vetanake.

Asambleti Zoran Danilloviq, para partisë "SRPSKA", pyeti nëse ka ndonjë zgjidhje alternative për mbushjen e gropave, derisa procedura e tenderit zgjat.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se mbushja dhe asfaltimi i rrugëve është i njëjti tender dhe se aktualisht është i pamundur.

Kryesuesi pyeti nëse ka pasur mundësi, duke pasur parasysh që Ekologjia është e autorizuar për pastrimin e borës, ta bëjë edhe riparimin e gropave.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, është përgjigjur se Ekologjia nuk e ka pasur atë tender deri më tani.

Asambletja Sllagjana Rashiq, para partisë "SRPSKA", tha se problem i madh është dalja nga rruga afër restorantit "Mimoza" në rrugën kryesore dhe pyeti nëse mund të vendoset pasqyrë matanë rrugës, sepse edhe Këshilli lokal kërkojë zgjidhjen e këtij problemi.

Asambleti Zoran Danilloviq, para partisë "SRPSKA", tha se të njëjtin problem e paraqesin edhe vozitësit kur dalin nga rruga "Kosovka devojka", sepse majtas ekziston një kënd i vdekur dhe zgjidhja do të ishte ndalimi i dy vendeve për parkim në mënyrë që vozitësi të ketë shikueshmëri më të mirë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se fillimisht duhet ta mbajnë një takim me komandantin e policisë për ta vendosur tabelën e ndalimit të parkimit.



Asambletja Snezhana Jovanović, para partisë "SRPSKA", tha se që nga koha e drejtorit të mëparshëm të Urbanizmit, ajo ka kërkuar që të kontaktohet kur është duke u punuar në ndonjë projekt në Kishnicë apo kur është dashur të gjendet një zgjidhje për ndonjë problem, por kjo nuk është respektuar asnjëherë. "Ju lutem, nëse nuk dëshironi të më kontaktoni, atëherë thuni "Snezho, delegojë dikë tjetër me të cilin mund të bisedojmë", si dhe për gjithçka që bëhet në Kishnicë të flasni me anëtarët e Këshillit lokal ose me ndonjë person tjetër, ndërsa jo të punoni, të betononi dhe bëhet ndonjë problem, ku nuk mund të zgjidhet problemi".

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:


8. Të ndryshme.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 14:00.

Procesmbajtësi:  
Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milan Dimitrijević